



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II nr.922/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen përmbareme të kreditorit S.K. nga Lipjani, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit D.S.K. avokate nga Lipjani, kundër debitorit Pozhegu Brothers shpk me seli në Prishtinë, duke vendosur sipas detyrës zyrtare për kompetencën lëndore, lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.106/2023 të datës 10.05.2023, jashtë seancës me datë 02.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e shkallës së dytë, Shpallet Jokompetente, në pikëpamje lëndore për vendosjen e kësaj çështje përmbareme.

Pas plotfuqishmërisë së këtij Aktvendimi, lënda do t'i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, si gjykatë kompetente për vendosjen e kësaj çështje përmbareme, për të vendosur sipas ankesës së kreditorit ndaj aktvendimit Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.106/2023 të datës 10.05.2023.

A R S Y E T I M

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, ka pranuar lëndën e cila është regjistruar me numrin K.Dh.Sh.II.nr.922/23 në çështjen përmbareme të kreditorit S.K. nga Lipjani kundër debitorit Pozhegu Brothers shpk me seli në Prishtinë, me bazë juridike: përmbareme.

Dhomat e Shkallës së Dytë, pas shqyrtimit të lëndës dhe objektit të shqyrtimit që ka të bëjë me vendosjen sipas ankesës së kreditorit, ndaj aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.106/2023 të datës 10.05.2023, e duke vlerësuar kompetencën e saj lëndore, konsideron se kompetente për të vendosur në këtë çështje përmbareme është Gjykata e Apelit.

Bazuar në dispozitat e Nenit 13 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, kjo gjykatë ka kompetencë për të gjykuar si parim, vetëm (par.1 pika 1.1) *“kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”*.

Për të referuar çështjet në kompetencën lëndore të kësaj Gjykate, vlerësojmë se gjykatat duhet të kenë si pikënisje qëllimin e themelimit të Gjykatës Komerciale dhe rrjedhimisht fushëveprimin e saj. Në këtë drejtim me Nenin 2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale përcaktohet se *“Ky ligj zbatohet ndaj të gjithë personave juridikë dhe fizikë, vendorë dhe të huaj përfshirë shoqëritë tregtare të përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare në Republikën e Kosovës të cilët kanë konteste tregtare ndërmjet tyre”*. Së këndejmi, konsiderojmë se kjo Gjykatë në fushëveprimin e saj primar ka tagër për të vendosur vetëm për kontestet që në plan të parë kanë karakter tregtar, apo çështje të ndërsjella të paraparë me Nenin 13 të Ligjit që rrjedhin nga afarizmi i tyre.

Meqë në rastin konkret, palë ndërgjyqëse, në këtë çështje përmbarimore, është personi fizik në cilësinë e kreditorit, Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerësoi se kjo çështje nuk hyn në kompetencë lëndore të Gjykatës Komerciale.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë e në kuptim të nenit 17, 18, 19, 29 dhe 392 pika b) të LPK-së, dhe Ligjit nr.08/L-15 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.Dh.Sh.II nr.922/2023 datë 02.02.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha